



Pranimi / Dorezimi Prilazja / Predato Received / Delivery	15.04.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Printëq Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	1892/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.197/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.2825/18 të datës 24.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.145/2019 të datës 28.02.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rruga “Dibran Paloji”, Nr.12 në Komunën e Obiliqit, kundër Vendimit me Nr. XII-07 të datës 04.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike “**ndërprerje e marrëdhënies së punës**” në shërbimin civil nga Komisioni Disiplinor, duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër Anr.145/ 2019 e datës 28.02.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokollit XII-07 i datës 04.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Obiliqit dhe Vendimi me numër prot.XII/92 të datës 11.09.2018.

A r s y e t i m

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin e datës 04.02.2019 ka parashtruar ankese me datës 28.02.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se Vendimi i datë 04.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Obiliqit, nuk është nxjerre në bazë të Vendimit me numër Anr.787/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, të datës 14.01.2019, dhe kundër Vendimit me Nr.prot: XII-92 të Komisionit Disiplinor të datës 11.09.2018, i cili i ka shqiptuar masën disiplinore **ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil**, që pretendon se janë përdorur standarde të dyfishta, nuk ka vepruar njëjtë për të gjitha raste në raport me kolegët e tij të cilët janë të përfshirë në këtë Aktgjykim, dhe pretendon që ti shqiptohet masë disiplinore më e lehtë dhe të kthehet në vendin e punës.

Administrimi i provave: Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Aktgjykimin A.nr.2825/18 të datës 24.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative; Vendimit me numër Anr.787/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Parashtesë për plotësim të padis e datës 30.09.2019;Padi e datës 29.11.2018; Përgjigje në padi e datës 05.03.2020; Aktvendim i datës 25.02.2020; Ankesën me numër protokollit 1057/2019 të datës 28.02.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi nr.XII-92 i datës 04.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimi (E-maili) i datës 29.01.2019 mbi zbatimin e vendimit të Këshillit; Vendimi nr.II-52 i datës 25.01.2019; Vendimi nr.II-51 i datës 25.01.2019; Ankesën me numër protokollit 7195/2018 të datës 29.11.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 02.11.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendim i datës 11.09.2018 i Komisionit Disiplinor; Vendim i datës 29.06.2016 i Komisionit Disiplinor; Ankese e ankuesit e datës 03.10.2018 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Aktgjykimin PKR.nr.320/2014 i datës 05.04.2016 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktgjykimin PKR.nr.271/15 i datës 19.04.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Kërkesa e datës 29.06.2018; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 30.11.2018, Përgjigja në ankese e datës 11.12.2018 me shkresat e bashkangjitura; Akt emërimi i ankuesit i datës 03.01.2012, Përshkrimi i detyrave të punës i datës 01.02.2011; Vendim i datës 10.03.2014, Vendim i datës 27.01.2014, Njoftim i datës 17.04.2014; Përgjigje e datës 14.05.2016 në kërkesë të Komunës së Obiliqit, nga Prokuroria Speciale; Opinion ligjor nga MAP i datës 29.09.2016; Kërkesë për opinion ligjor e datës 15.04.2016; Njoftimi i datës 09.08.2018; Kërkesa e datës 07.08.2018; Akt emërimi i datës 20.03.2013; Akt emërimi i datës 23.08.2017; Akt emërimi i datës 01.04.2011.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar.**

Kolegji i për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Njësia e personelit në Komunë të Obiliqit ka njoftuar Komisionin Disiplinor, lidhur me zhvillimin e procedurës disiplinore, ndaj ankuesit duke marr për bazë Aktgjykimin me numër PKR.nr.320/2014, të datës 05.04.2016, në të cilin ankuesi është shpall fajtor për kryerje të veprës penale “*Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*”, e parashikuar me nenin 422 paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në bazë të cilit është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muajve, që i është konvertuar në dënim me gjobë në shumë prej 2000 € (dy mijë euro).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit i cili pretendon se Vendimi me Nr.prot: XII-92 i Komisionit Disiplinor i datës 11.09.2018, është i kundërligjshëm me rastin e shqiptimit të masës së rëndë disiplinore, **ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil**, duke theksuar se janë përdorur standarde të dyfishta, nuk ka vepruar njëjtë për të gjitha rastet në raport me kolegët e tij, duke u bazuar në Aktgjykimin me numër PKR.nr.320/2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, të cilat pretendime janë të pa bazuara sepse ndaj ankuesit është iniciuar procedurë disiplinore me rastin e pranimit të Aktgjykimin me numër PKR.nr.320/2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ku me datë 11.09.2018 ankuesit i është shqiptuar masën disiplinore, **ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil**, me Vendimin me numër protokollit XII-92. Kolegji ka konstatuar se në bazë të Aktgjykimit ankuesi ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale, pas marrëveshjes me Prokuroren e Shtetit, pasi që dënimi me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muajve, tij zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 2000 € (dy mijë euro), rrjedhimisht në bazë të këtij Aktgjykimi paraqitja e rastit në Komisionin Disiplinor nga Kryetari i Komunës së Obiliqit, është bërë në përputhje me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës respektivisht me nenin 63 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit, ka vepruar në pajtim me dispozitat nenit 71, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1,1.2 dhe 1.3, të Ligjit Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: „**1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar**”, si dhe në pajtim me nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 04/2011, për Procedura Disiplinor në Shërbimin Civil, ku thuhet se: **për shkeljet e rënda - serioze të përcaktuara me nenin 6 të kësaj Rregulloreje, nëpunësit civil, mund t'i shqiptohet këto masa disiplinore: ndërprerje e marrëdhënies së punës në Shërbimin civil nga Komisioni Disiplinor pa dëmtuar apo rekrutuar të drejtën në pension**”, me rastin e inicimit të procedurës disiplinore. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor në rastin e shqiptimit të masës disiplinore “**ndërprerjeje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil**”, pa dëmtuar të drejtën e daljes në pension”, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi sepse nëpunësi civil ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni i Disiplinor i Komunës së Obiliqit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit XII-92 të datës 11.09.2018, ankuesit i është shqiptuar masë disiplinore „**Ndërprerjeje e marrëdhënies së punës**” me arsyetimin se nëpunësi ka kryer vepër penale, sipas Aktgjykimit me numër PKR.nr.320/2014, të datës 05.04.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka vepruar në pajtim me nenin 63 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **“Nëse nëpunësi civil i cili shpallet fajtor dhe dënohet për kryerje të veprës penale, autoritetet kompetente administrative detyrohen që nga ata elemente të vendimit të gjykatës kompetente, që përbëjnë shkelje të parimeve dhe të rregullave administrative, duhet të urdhërojnë shkarkimin e nëpunësit civil”**, neni 66 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 pika 4.3 të Ligjit Nr. 03/ L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **“Masa disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil”...për shkelje të rënda-serioze shqiptohen masat disiplinore si në vijim:.....ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nga komisioni disiplinor”**, në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i papabuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se. ankuesi edhe më parë ka pasur aktakuzë të ngritur në çështje penale, duke u bazuar në Përgjigjën numër 016 të datës 15.05.2016 të Prokurorisë së Shtetit-Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, është theksuar se ankuesi ka qenë i përfshirë në aktakuzën me numër PPS.Nr.136/2014 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, si dhe Aktgjykimin me numër PKR.nr.320/2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinës-Departamenti për Krime të Rënda, për kryerjen e veprës penale **“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**, e parashikuar me nenin 422 paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit, më datë 11.09.2018, ka nxjerr Vendimin me numër protokollit XII-92, duke vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 63 paragrafin 4, neni 66 paragrafin 4 pika 4.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u ndërlidhur me nenin 8 pika 1.1 të Rregullores Nr.04./2011 për Procedurën Disiplinore në Shërbimin Civil si dhe nenin 7 paragrafin 1 pika 1.3 të Rregullores Nr.01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, duke i shqiptuar masën disiplinore **“Ndërprerjeje e marrëdhënies së punës”** nëpunësi ish i punësuar në Komunën e Obiliqit, në pozitën **“Nëpunës për çështje pronësore”**, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Kadastër dhe Pronë në Sektorin Pronësor, i cili ka kryer vepër penale

“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, sipas Aktgjykimit me numër PKR.nr.320/2014, të datës 05.04.2016 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me përbërjen të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Obiliqit që dy anëtarët e komisionit nuk janë profesional, kjo nuk qëndron sepse në bazë të provave të lëndës është konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Obiliqit, është në pajtim me nenin 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/ L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcakton se: *“Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë nga radhët e nëpunësve civilë, me përgatitje superiore shkollore, emërohen nga Sekretari i Përgjithshëm apo nga pozitat ekuivalente të institucioneve përkatëse në periudhë dy (2) vjeçare, me mundësi vazhdimi, dhe pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë sidomos diversitetin gjinor”,* që në rastin konkret dy anëtarët e komisionit janë nga radhët e nëpunësve civilë, me përgatitje superiore shkollore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Vendimi i datë 04.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Obiliqit, nuk është nxjerre në bazë rekomandimeve të Vendimit me numër Anr.787/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, të datës 14.01.2019, në rastin konkret pretendimet janë të pa bazuar sepse Komuna e Obiliqit brenda afatit ligjor me datë 29.01.2018 ka njoftuar Këshillin, lidhur me zbatimin e Vendimit me numër Anr.787/2018 të datës 14.01.2019 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, mbi bazë të cilit njoftim Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Obiliqit me datës 04.02.2019 ka nxjerre Vendimin me numër XII-07, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit me nr. XII/26756 të datës 03.10.2018, me të cilin ka alenë në fuqi Vendimin e datës 11.09.2018 të Komisionit Disiplinor, me numër nr.XII/92.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Obiliqit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli XII-07 të datës 04.02.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe të Ankesave në Shërbimin Civil, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën e juridike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.145/2019.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit,*
- *Gjykatës Themelore, Gjyqtares Arjeta Sadiku,*
- *Kryetarit te Komunës se Obiliqit;*
- *Udhëheqësit të Personalit në Komunën e Obiliqit dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK*